

04.02.2021

Ora 12:40

**RENDI I DITËS**


**Projektvendim “Për miratimin e modeleve të dokumentacionit të punës që do të përdorin komisionet e qendrave të votimit për zgjedhjet e pjeshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Staf i KQZ:      **Y. Merkaj, M. Koja, E. Meta**
- **Parti Politike:**      **PD (M. Logu), LSI (A. Kaziaj)**
- **OJQ:**      **KRIK**

**Z. I. Celibashi:** Mirëdita të gjithëve! Atëherë fillojmë me çështjet që kemi në rendin e ditës, ne seancën e sotme, që janë tre çështje për t’u shqyrtuar. Pika e parë ka të bëjë me projektvendimin “Për miratimin e modeleve të dokumentacionit të punës që do të përdorin komisionet e qendrave të votimit për zgjedhjet e pjeshme të 6 Marsit 2022”. Pika e dytë ka të bëjë me projektvendimin për caktimin e vendeve të numërimit të votave të ZAZ-së nr. 2, 3, 4, 5, 19, 21, 22, 23, 24, 26, 43, 54 dhe 55. Pika e tretë projektvendimi që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e Koalicionit “Shtëpia e Lirisë”. Atëherë mendoj që të fillojmë me pikën e fundit të rendit të ditës, ta kalojmë si pikë e parë e rendit të ditës, nëse nuk kemi ndonjë kundërshtim nga përfaqësuesit e partive politike dhe pastaj vazhdojmë me pikat e tjera.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.02.2022*


**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** I nderuar, në njoftimin që na është dërguar dje në formë elektronike nga administrata zgjedhore, siç e relatuat dhe ju me të drejtë, është parashikuar që pika e tretë e rendit të ditës do të jetë “Shqyrtimi i kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Shtëpia e Lirisë” për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 Mars 2022”. Duke qenë se ne jemi si subjekt zgjedhor të pranishëm në këto mbledhje dhe do të kërkohet besoj që edhe të shprehemi mbi këtë kërkesë, kërkojmë që rendi i ditës të qëndrojë ashtu siç është. Paraprakisht të na vihet në dispozicion nga ana e administratës zgjedhore, zyrtarisht kërkesa dhe marrëveshja në mënyrë që ne pastaj të kemi mundësi të shprehemi mbi këtë kërkesë. Ne kemi pasur mundësi të njihemi me disa materiale që janë publikuar nga media, por do të kishim nevojë që të njihemi zyrtarisht, në mënyrë që më pas të kemi edhe mundësi të shprehemi mbi këtë kërkesë.

**Z. I. Celibashi:** Po! Përfaqësuesi i Lëvizjes Socialiste për Integrim!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Faleminderit zoti Kryetar! Mendoj që kërkesa e bërë nga ana e kolegut Logu, nuk ka legjitimitet të karakterit aktiv, ose pasiv. Pardje nga ana juaj janë miratuar subjektet zgjedhore, të cilat do të garojnë në zgjedhjet e 6 marsit. Në dijeninë time, zoti Logu përfaqëson Partinë Demokratike, nuk përfaqëson një koalicion zgjedhor dhe mund të ketë interes për koalicionin. Kërkesa e bërë prej tij është thjesht të themi një deklaratë publike me karakter politik sipas qëndrimeve të mbajtura. Nuk shoh as interesin zgjedhor që ka zoti Logu, ose çështje të karakterit shqetësues që mund të ketë ai në vetvete apo, të themi, të subjektit që ai përfaqëson.

**Z. I. Celibashi:** Po, edhe njëherë përfaqësuesi i Partisë Demokratike!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.  
Dt.04.02.2022*

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti Celibashi! Mendoj që ka një praktikë shumë të mirë dhe të konsoliduar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që palëve, përfaqësuesve të partive politike t'ju vihen në dispozicion aktet për të cilat thirren të japin mendimin e tyre. Sigurisht që vendimmarrja u takon organeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në këtë rast Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Por, përsa kohë jemi thirrur do të kemi mundësi që të shprehim mendimin tonë, mendoj që është një kërkesë e drejtë, legjitime, që të na vihet në dispozicion zyrtarisht nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kërkesa, si dhe marrëveshja e koalicionit që është depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Besoj, duke qenë se sapo na u vu në dispozicion, besoj që është një diskutim...

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Zoti kryetar, tani zoti Logu në qoftë se, që në fillim të fjalës vet do të impostojë politikisht këtë çështje ndërkohë që ne në rend dite kishim dy pika të tjera për të miratuar. Ndërkohë që thashë dhe e rithem, fakti që nuk ka legjitimitet që zoti Logu të shprehet për një kërkesë koalicioni, ku në koalicion nuk është partia e tij. Për çfarë do të shprehet zoti Logu në këtë rast? A u regjistrua partia e tij? Të shprehet për interesat, të drejtat dhe detyrimet e partisë së vet.

**Z. I. Celibashi:** Atëherë, më lejoni që t'i japim fund këtij diskutimi në lidhje me këtë çështje. Ne po i vëmë në dispozicion edhe përfaqësuesit të Partisë Demokratike dokumentacionin shoqërues të kërkesës për regjistrimin e këtij koalicioni. Në respekt të të drejtës të çdo subjekti zgjedhor, apo dhe partie politike, por tashmë ata, Partia Demokratike si subjekt zgjedhor për të kërkuar dhe për të

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.02.2022*

marrë informacion apo dokumentacion nga Komisioni i Qendror i Zgjedhjeve. Kështu që po e vë në dispozicion, pastaj gjykimin dhe vlerësimin në lidhje me atë si dokumentacion do ta bëjmë gjatë shqyrtimit të çështjes përkatëse.

Atëherë vazhdojmë sipas rendit të ditës, meqenëse nuk e patëm dakordësinë për ta bërë ndryshimin e rradhës së shqyrtimit të çështjeve. Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, që ka të bëjë me projektvendimin “Për miratimin e modeleve të dokumentacionit të punës, që do të përdorin komisionet e qendrave të votimit, në zgjedhjet e pjesshme të 6 Marsit 2022”. Shkurtimisht, kush do ta relatojë nga administrate? Dakord!

**Z. Y. Merkaj:** Referuar nenit 40, 42 të Kodit Zgjedhor, komisioni i qendrës së votimit përgjigjet për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në qendrën e votimit. Kryen veprimtari të tilla që lidhen me regjistrimin në librin e protokollit të mbledhjeve dhe vendimeve, kërkesa dhe ankesa si dhe njoftime, vërejtje nga vëzhguesit. Shënohen numrat e kodeve të sigurisë me të cilat vulozet kutia e votimit, kutia e materialeve zgjedhore dhe numri i kodit të sigurisë së vulës së dëmtuar si dhe numri i kodit të sigurisë me vulat shtesë. Merr vendime për caktimin e detyrave të anëtarëve të komisionit të qendrës së votimit. Vendim për hapjen e votimit, vendim për largimin e personave të caktuar në mjediset e qendrës së votimit, vendim për pezullimin e votimit, kërkimin e ndihmës nga policia, largimin e punonjësit të policisë, mbylljen e votimit, si dhe vendimin për përcaktimin e numrit të personave që kanë votuar. Komisioni i qendrës së votimit dokumenton përmes procesverbaleve: pezullimin e votimit, për administrimin e materialeve zgjedhore, fletëve të votimit që janë caktuar, lloje zarfesh të emërtuar si specifike për procesverbalet e vulosjes së kutive së votimit, për fletët e votimit, fletët e dëmtuara dhe vërtetimet e identifikimit elektronik të zgjedhësve. Përsa më

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.02.2022*

sipër janë ideuar modelet përkatëse, të cilat gjenden bashkëlidhur projektvendimit si dhe specifikimet teknike të tyre. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe dokumentacionin dhe modelet përkatëse për komisionin e qendrës së votimit, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Po, faleminderit zoti Sekretar! Përfaqësuesit e partive politike në parim në lidhje me projektaktin?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti Celibashi! Jemi njohur me projektaktin në formën elektronike nga ana e administratës së KQZ-së. Nuk kemi asnjë rezervë apo objeksion lidhur me këtë projektakt dhe shprehemi dakord në parim me miratimin e tij, faleminderit!


**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesi i LSI-së?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Dakord me përmbajtjen i nderuar!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Atëherë meqenëse jemi dakord me përmbajtjen e projektaktit, e miratojmë projektaktin pikërisht sipas draftit të propozuar.

**Vendimi nr. 44**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



04.02.2021  
Ora 12:48

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për caktimin e vendeve të numërimit të votave të ZAZ nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 19, nr. 21, nr. 22, nr. 23, nr. 24, nr. 26, nr. 43, nr.54, nr.55, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.**


**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  - 2. Stafi KQZ:      **Y. Merkaj, M. Koja, E. Meta**
- **Parti Politike:**      **PD (M. Logu), LSI (A. Kaziaj)**
- **OJQ:**      **KRIK**

**Z. I. Celibashi:** Kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës, që ka të bëjë me miratimin e ambienteve të VNV-ve për KZAZ-të respektive, ku do të zhvillohen zgjedhjet e pjesshme të 6 marsit.

**Z. Y. Merkaj:** Komisioni Rregullator me vendimin nr. 2, datë 22.01.2022, ka miratuar afatet proceduriale që do të zbatohen për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, që do të zhvillohen në datën 6 Mars 2022. Gjithashtu ka paraqitur afatin kur prefektët e qarqeve Shkodër, Dibër, Durrës, Tiranë dhe Fier, duhet të paraqesin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve listën e plotë të objekteve brenda territorit të qarkut, të cilat përmbushin kushtet e parashikuara në ligj, për t’u përcaktuar si vend i numërimit të votave. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve u është drejtuar prefektëve për të vënë në dispozicion listën e plotë të objekteve, të


*Zbardi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.02.2022*

qarqeve përkatëse. Në përgjigje të kërkesës së Komisionerit, ka kthyer përgjigje prefekti i Qarkut Shkodër. Ka paraqitur listë të objekteve, brenda territorit të qarkut për katër KZAZ-të, të cilat përmbushin kriteret e përcaktuara si vend i numërimit të votave. Kështu për KZAZ-në nr. 2 është paraqitur si propozim pallati i sportit “Qazim Dervishi”, me sipërfaqe 650 m<sup>2</sup>. Për ZAZ-në nr. 3 është paraqitur palestra e shkollës “Shejnaze Juka”, me sipërfaqe 200 m<sup>2</sup>. Për ZAZ-në nr. 4 është paraqitur palestra e shkollës “Ismail Qemali”, me sipërfaqe 350 m<sup>2</sup> dhe për ZAZ-në nr. 5 është paraqitur palestra e shkollës “Edit Durham” me sipërfaqe 200 m<sup>2</sup>. Objektet e propozuara nga prefektët, plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 93, 94 të Kodit Zgjedhor, si dhe kriterin teknik të sipërfaqes së përcaktuar në vendimin nr. 3, datë 09.02.2021, të Komisionit Rregullator. Prefekti i Qarkut Dibër ka dërguar listën e objekteve dhe ka propozuar për KZAZ-në nr. 11, palestrën e shkollës së mesme profesionale “Nazmi Rushiti”, me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup>. Ky objekt plotëson kriteret, të parashikuara në nenin 93, 94 të Kodit Zgjedhor. Prefekti i Qarkut Durrës ka paraqitur për ZAZ-në 21, pallatin e sportit “Ramazan Njala”, me sipërfaqe 500 m<sup>2</sup>. Për ZAZ-në nr. 22, ka paraqitur shkollën e mesme “Marie Kaçulini” me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup>, për ZAZ-në nr. 23 ka paraqitur shkollën “Jan Kukuzeli” me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup> dhe për ZAZ-në nr. 24, ka paraqitur shkollën “Leonik Tomeo” me sipërfaqe 234 m<sup>2</sup>. Të katër propozimet plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 93, 94, për sipërfaqen dhe largësinë nga qendrat e votimit. Prefekti i Qarkut Tiranë ka paraqitur kërkesën për ZAZ-në nr. 26, Bashkia Vorë, për shkollën 9-vjeçare “Marqinet”, me sipërfaqe 500 m<sup>2</sup>. Për Bashkinë Rrogozhinë, për ZAZ-në nr. 43, ka paraqitur si propozim palestrën e shkollës “Haxhi Qehaj” me sipërfaqe 420 m<sup>2</sup>. Edhe këto dy propozime plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 93, 94 dhe kriterin teknik të sipërfaqes. Prefekti i Qarkut Fier ka paraqitur propozimin për vendin e numërimit të votave për Bashkinë

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.02.2022*

Lushnje, për ZAZ-në nr. 54, palestrën e shkollës “Skënder Libohova” me sipërfaqe 504 m<sup>2</sup> dhe për ZAZ-në nr. 55 ka paraqitur hollin e Muzeut Historik me sipërfaqe 200 m<sup>2</sup>. Këto objekte plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 93, 94, të Kodit Zgjedhor përsa i përket sipërfaqes dhe largësisë nga qendrat e votimit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe listën e objekteve që do të përdoren si VNV, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike në parim me projektaktin?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti Celibashi! Unë kam vetëm një pyetje, në qoftë se më lejohet, për administratën?

**Z. I. Celibashi:** Po!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Vendet e numërimit të parashikuara, ose të propozuara në këtë projektvendim, janë të njëjtat me ato që janë përdorur dhe në zgjedhjet e 25 prillit?

**Z. Y. Merhaj:** Të gjitha, me përjashtim të ZAZ-së nr.5, palestra e shkollës “Edit Durham”, e cila ka qenë në zgjedhjet e kaluara tek shkolla “Xheladin Fishta”.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Ne nuk kemi, i nderuar, ndonjë objeksion apo kundërshtim. Kishim dëshirë vetëm të informoheshim në qoftë se është ruajtur e njëjta praktikë që është ndjekur në përcaktimin e vendeve për zgjedhjet e 25 prillit, për të cilat, të paktën nga informacione që kemi ne dhe strukturat tona, nuk ka

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.02.2022*

pasur probleme lidhur me zhvillimin normal të procesit në këto ambiente, faleminderit!


**Z. I. Celibashi:** Po, janë të njëjtat ambiente që janë përdorur në zgjedhjet e 25 prillit. Po, përfaqësuesi i Lëvizjes Socialiste për Integrim!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Po, zoti Kryetar! E gjejmë në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe të akteve nënligjore, përcaktimi që po i bëhet projektvendimit që ju do miratoni. Nuk kemi ndonjë kundërshtim lidhur me përmbajtjen e tij.

**Z. I. Celibashi:** Mirë, faleminderit! Atëherë meqenëse jemi dakord me draftin e propozuar e miratojmë këtë projektakt sipas këtij drafti.

**Vendimi nr. 45**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



**RENDI I DITËS**

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e Koalicionit “Shtëpia e Lirisë”, (Sh-L), për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.


**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Stafi KQZ:      **Y. Merkaj, M. Koja, E. Meta**
- **Parti Politike:**      **PD (M. Logu), LSI (A. Kaziaj)**
- **OJQ:**      **KRIK**

**Z. I. Celibashi:** Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës së Lëvizjes Socialiste për Integrim, për t’u regjistruar si koalicion në këto zgjedhje. Atëherë i japim fjalën për ta prezantuar si kërkesë përfaqësuesit të Lëvizjes Socialiste për Integrim, meqenëse nuk është nevoja për ta relatuar.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Po, ashtu siç parashikohet dhe nga përmbajtja e kësaj kërkesë, i nderuar zoti kryetar, kërkesa është depozituar nga ana e Lëvizjes Socialiste për Integrim. Sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor, lidhur me, po themi, atë që është partia udhëheqëse në këtë koalicion, që është po Lëvizja Socialiste për Integrim. Është bërë kërkesa në datë 31.01.2022. në përmbajtje të kërkesës sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor dhe përkatësisht nenit 65, pika 3,

Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të*

*Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve*

*Dt.04.02.2022*

janë listuar të gjitha ato që ligjvënësi kërkon që të jenë në një kërkesë për regjistrimin e një koalicioni zgjedhor. Të gjithë elementet e nevojshme që kanë të bëjnë: me emrin e koalicionit, me partinë udhëheqëse që kërkon Kodi Zgjedhor në nenin 65, pika 3 të tij. Pjesa e shkronjave nistore sesi do titullohet ky koalicion, pra “Shtëpia e Lirisë”, Sh-L shkronjat nistore, sigla e koalicionit, i nderuar zoti kryetar. Bashkëlidhur kësaj është parashikuar perfekt të themi, të kërkesave të ligjit dhe marrëveshja e vetëpërfaqësuesve, cilët janë bashkuar për të lidhur këtë koalicion zgjedhor. Kërkojmë nga ana juaj miratimin e tij, duke qenë se është në përputhje me parashikimet e ligjvënësit. Nuk ka asnjë, domethënë, pavarësisht se zoti Logu kur ka dashur të njihej me këtë kërkesë, nuk ka asnjë shkelje të karakterit të procedurës. Kështu që kërkojmë që të miratohet sa më shpejt në mënyrë që të fillohet puna nga ana jonë, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Po, faleminderit zoti Kaziaj! Zoti Logu, fjala për ju!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti Celibashi! Pasi u njohëm me kërkesën e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në datën 31 janar 2022. Sigurisht pas një shqyrtimi shumë të kujdesshëm të Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore, vlerësojmë se kjo kërkesë përmban dy elemente, të cilat e pamundësojnë regjistrimin e këtij koalicioni zgjedhor. Së pari, neni 65 i Kodit Zgjedhor ka parashikuar në mënyrë të qartë se si koalicione zgjedhore regjistrohen vetëm ato parti politike, dy ose më shumë, që kanë fituar statusin apo cilësinë e subjektit zgjedhor. Kjo është një kërkesë minimale për legjitimimin e dy ose më shumë partive, për të kërkuar regjistrimin si koalicion zgjedhor. Konstatojmë se kjo në fakt është një kërkesë, qoftë e nenit 65 të Kodit Zgjedhor, po ashtu edhe nenit 2 të udhëzimit nr. 1, datë 23 dhjetor 2020 i

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të*

*Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve*

*Dt.04.02.2022*

Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Në fakt kërkesa e Lëvizjes Socialiste për Integrim është depozituar në datën 31 janar. Në një kohë kur vetë LSI-ja nuk e kishte fituar cilësinë e të qenurit subjekt zgjedhor. Pra, ka mungesë legjitimitimi qoftë ajo, qoftë subjekti tjetër Partia Demokristiane për të sjellë përpara këtij komisioni një kërkesë të tillë në datën që është bërë kjo kërkesë. Risjell në vëmendjen tuaj zoti Komisioner dhe sigurisht edhe të qytetarëve që ndjekin këtë seancë, se Lëvizja Socialiste për Integrim është regjistruar si subjekt zgjedhor me vendimin nr. 34, datë 2 Shkurt 2022. Pra, është regjistruar dy ditë pasi kishte paraqitur kërkesën për regjistrim si koalicion zgjedhor me dy subjektet e tjera. Nga ana tjetër Partia Demokristiane është regjistruar me vendimin nr. 38, datë 2 Shkurt 2022. Të dyja këto subjekte që përbëjnë edhe koalicionin “Shtëpia e Lirisë” në fakt janë regjistruar si subjekte pasi më përpara kishin paraqitur kërkesën e tyre. A mund të regjistrojë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve një koalicion zgjedhor ndërmjet dy partive, të cilat akoma nuk e kanë fituar statusin apo cilësinë si subjekte zgjedhore? Unë mendoj që neni 65 i Kodit Zgjedhor ashtu si edhe neni 2, i udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020 të Komisionerit Shtetëror e ndalon këtë gjë. Do të ishim sot, pra në shkelje të ligjit në qoftë se do procedonim me këtë kërkesë. Kjo në fakt, i nderuar zoti Komisioner, është parashikuar qartazi edhe në vendimin nr. 2, datë 22 Janar 2022, të Komisionit Rregullator, ku ka përcaktuar në pikën 9, që “koalicionet zgjedhore duhet të paraqesin kërkesën për regjistrim brenda 24 orëve nga miratimi i të gjitha kërkesave për regjistrimin e partive politike”. Atëherë sjellim në vëmendje, partitë politike janë regjistruar në datën 2 shkurt dhe unë i citova dy vendimet përkatëse. Ditën e djeshme ka qenë afati deri në orën 24:00 për të sjellë çdo kërkesë që dy ose më shumë subjekte kishin dëshirë të regjistroheshin. Nga ana e KQZ-së, të paktën nga komunikimi që kemi dhe mbase mund ta konfirmojmë këtu. Dje nuk ka pasur asnjë kërkesë për regjistrim koalicioni, çka në

*Zbardhi materialin audio*


*Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.02.2022*

fakt do të thotë që çdo subjekt, dy apo më shumë subjekte që kanë paraqitur kërkesë pardje, para 3 javësh, para 3 ditësh, e në një afat tjetër, kanë mungesë legjitimiteti dhe janë jashtë afateve procedurale. Pra, unë besoj që kjo kërkesë qoftë dhe për çështje legjitimimi të kërkuarit duhet rrëzuar dhe nuk duhet pranuar. Përsa kohë që brenda afatit që ka përcaktuar ligji, ka përcaktuar Komisioni Rregullator, ka përcaktuar neni 65 i Kodit Zgjedhor, ka përcaktuar udhëzimi nr. 1 datë 23.12.2020, ne nuk kemi pasur dhe nuk kemi asnjë kërkesë për regjistrimin e koalicionit zgjedhor. Elementi i dytë i nderuar, përveç anës procedurale është një element i anës materiale. Le ta marrim të mirëqenë për një moment që Lëvizja Socialiste për Integrim gëzonte legjitimimin për t'iu drejtuar këtij komisioni me një kërkesë për regjistrimin në një koalicion zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 Mars 2022. Nga leximi që i bëjmë kërkesës, por edhe vetë marrëveshjes në fjalë, citohet, “emri i koalicionit është “Shtëpia e Lirisë”, LSI, PD-Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit, PDK”, që i referohet Partisë Demokratiane. Kjo është në faqen e parë të kërkesës. Në faqen e dytë dhe është i rëndësishëm ky element, thuhet “partitë përbërëse të koalicionit janë, Lëvizja Socialiste për Integrim, Partia Demokratike e Shqipërisë-Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit dhe Partia Demokratiane”. Ecim më tej. Në përmbajtjen e marrëveshjes së koalicionit, thuhet “drejtuese politike e koalicionit është Partia Demokratike e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit”. Më tej i nderuar, në faqen 3 të kësaj marrëveshjeje, më përpara thuhet që “partitë përbërëse janë...”, dhe është “...Partia Demokratike e Shqipërisë, Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit” e nënshkruar nga zoti Flamur Noka. Cilat janë kërkesat ligjore që parashikon qoftë neni 65, qoftë neni 2 i udhëzimit nr. 1 të vitit 2020, sa i përket përbajtjes së një marrëveshjeje koalicioni? “Marrëveshja...” thotë, neni 2, “...duhet të përmbajë shprehjen e vullnetit të partive pjesëmarrëse për të qenë pjesëtarë të koalicionit”.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.02.2022*

Vullnetin i nderuar, në emër të një partie politike nuk e shprehin kushdo, por e shpreh ose kryetari i partisë së caktuar ose personat e autorizuar nga ana e tij. Në fakt në emër të Partisë Demokratike, siç është bërë me dije nëpërmjet shkresës me numër protokolli 213, datë 25 Janar 2022, është e qartë se kryetari i Partisë Demokratike dhe i vetmi person i autorizuar për të paraqitur kërkesa për regjistrim subjektësh, koalicionesh, etj., në emër të Partisë Demokratike dhe sigurisht dhe për të paraqitur kandidaturat, është zoti Lulzim Basha. Ose alternativisht në qoftë se do jetë e nevojshme për efekt të komunikimit me Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve është depozituar një autorizim i datës 21 Janar 2022, ku autorizohet zoti Indrit Sefa, apo eventualisht unë, në qoftë se zoti Sefa do të ishte i pamundur. Në rastin konkret, i nderuar, nga ana e Partisë Demokratike nuk ka, nuk ka pasur dhe nuk do të ketë asnjë lloj kërkesë për të qenë pjesëmarrës, drejtues politik, apo udhëheqës në një koalicion zgjedhor, cilido qoftë ai. Ndaj çdo lloj referencë që është bërë në këtë shkresë ndaj Partisë Demokratike të Shqipërisë është në fakt në kundërshtim me nenin 65 të Kodit Zgjedhor, dhe nenit 2 të udhëzimit që unë sapo citova. Pra, edhe në përmbajtje qoftë të kërkesës, qoftë e marrëveshjes ka elemente paligjshmërie. Po të marrim një rast hipotetik, në fakt nuk rezulton as nga regjistri i partive politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe as pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që të kemi një subjekt zgjedhor që quhet Partia Demokratike e Shqipërisë-Komisioni i Rethemelimit. Duke qenë se nuk ka një subjekt të tillë, besoj që referenca, mendojmë, mbase dhe gaboj, referenca i bëhet Partisë Demokratike të Shqipërisë, e cila siç sapo thashë është një parti politike që ka paraqitur një kërkesë për regjistrim. Është regjistruar si subjekt zgjedhor me vendimin nr. 33, datë 2 Shkurt 2022, me kryetar zotin Lulzim Basha. Me përfaqësues në rast se është e nevojshme për efekt të komunikimit me KQZ-në, me zotin Indrit Sefa dhe zotin Marash Logu. Asnjë, as zoti Basha, as përfaqësuesit e tij

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.02.2022*

nuk kanë shprehur as dakordësi, as vullnet, as kërkesë për t'u regjistruar si koalicion zgjedhor. Pra, të dy këto elemente, i nderuar, besoj që duke u marrë së bashku, por do të mjaftonte dhe njëri prej tyre, e pamundësojnë dhe e ritheksoj, e pamundësojnë, sado që kemi dëshirën dhe vullnetin e mirë që të regjistrohet ky koalicion në atë formë, në atë përmbajtje që është paraqitur përpara Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Një, sepse i mungon afati dhe dy, sepse ka përfshirë një parti politike që nuk ka pikën e vullnetit, as pikën e dëshirës për të qenë në një koalicion zgjedhor të atillë siç është kompozuar ky koalicion. Prandaj ne vlerësojmë dhe kërkojmë që në emër të Partisë Demokratike të Shqipërisë, kjo kërkesë për regjistrim koalicioni të rrëzohet, të refuzohet nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, duke garantuar që gjithë ky proces nga fillimi deri në fund të jetë një proces që i nënshtrohet vetëm ligjit, ligjit dhe vetëm ligjit, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Po, faleminderit zoti Logu! Po, përfaqësuesi i Lëvizjes Socialiste për Integrim!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Faleminderit zoti kryetar! E dëgjova me shumë kujdes kolegun Logu. Recidivizmi i partisë së tij në humbje të njëpasnjëshme nuk mund të justifikohet me kërkesa të këtij karakteri që nuk përmbajnë as elementë të ligjit, por as elementë minimale të logjikës, të themi, të zgjedhjeve. Zoti Logu flet për dispozitat ligjore dhe ndërkohë interpreton sipas mënyrës së vet interpretimit. Ligjvënësi ka parashikuar qartë si afatet shteruese, afatet përfundimtare, brenda të cilit duhet të regjistrohet. Nuk ka thënë dhe në asnjë rast nuk flitet se kur sillet një kërkesë. Kjo është një pjesë që zoti Logu duhet ta ketë shumë të qartë si jurist. Mesa shoh ato që janë direktivat politike, të dhënave prej tij nga ai që mban me çdo kusht një parti politike, duke blinduar dhe dyert e saj, nuk kanë të bëjnë në

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të*

*Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve*

*Dt.04.02.2022*

vetvete me ato që janë akte ose kritere të karakterit dhe procedurës dhe të ligjit. Zoti Logu foli për dy pika, për pikën e parë që janë afatet të cilat nuk qëndrojnë. Afatet janë të tilla që një kërkesë bëhet brenda afateve të caktuara dhe jo jashtë saj. Në momentin që sillet jashtë saj aty mund të jetë një kërkesë nul dhe jo e jashtëligjshme se s'kemi pse flasim për jashtëligjshmëri në këtë rast. Përsa i përket pjesës tjetër të pikës që tha zoti Logu, të siglës, marrëveshjes së bërë nga ana jonë me Partinë Demokristiane Shqiptare dhe Komisionin e Përkohshëm të Rithemelimit, i them zotit Logu që faktet tregojnë ndryshe. Nuk mundet që t'i tregojmë shqiptarëve që në një vend, në një ambjent të mbyllur, me 1900 karrige, të fusin pesë mijë qytetarë dhe ndërkohë...

**Z. I. Celibashi:** Mundet të qëndrojmë...ju lutem zoti Logu...

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Ju lutem zoti Logu, jeni jurist, jeni avokat, por ligjin duhet ta lexoni si e ka bërë ligjvënësi, jo sipas interesave të partisë tuaj. Unë për ligjin ju fola, ju thashë... Afatet e parashikuara në ligj janë afatet përfundimtare, jashtë atyre nuk mund të regjistrohet as si subjekt zgjedhor dhe as si koalicion zgjedhor. Përsa i përket kërkesës sonë, i nderuar zoti Kryetar, është në përputhje të plotë me ato që janë parashikimet e Kodit Zgjedhor. Siç ju thashë zoti Logu citoi nenin 65. Neni 65, pika 3 e Kodit Zgjedhor thotë "Në momentin e regjistrimit, koalicioni duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të koalicionit", gjë që e keni fare të qartë dhe në kërkesë dhe në marrëveshjen bashkëlidhur kësaj. "Për nevoja të zbatimit të këtij ligji" thotë ligjvënësi, "të gjitha të drejtat dhe detyrimet që përcakton ky ligj për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit". Pra, këto dy elemente mjaftojnë që të identifikohet sipas kërkesës së bërë në datë 31.01.2022, Lëvizja Socialiste si parti

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.02.2022*

udhëheqëse e koalicionit me të gjitha ato që janë kërkesat e ligjit. Përsa i përket emrit të koalicionit, shkronjave nistore dhe pjesës së siglës së koalicionit. Pra, të drejtat dhe detyrimet lidhur me të i merr Lëvizja Socialiste për Integrim. Marrëveshja në preambulën e saj e ka të qartë se për çfarë është krijuar ky koalicion. I lutem kolegun Logu, ta lexojë se do t'i duhet për zgjedhjet e ardhshme, duke qenë se asnjë parti nuk pranoi të bënte koalicion me atë që ka mbetur nga ajo parti që ishte partia më e madhe e opozitës. Sjell në vëmendje po ashtu të zotit Logu, që për deklaratat e këtij karakteri, duhet të kenë një interes vetë partia e tij. Çfarë interesi ka? Nuk legjitimohesh në këtë interes, i nderuar zoti koleg! Kërkojmë nga ana juaj zoti kryetar, të procedoni me regjistrimin e Koalicionit "Shtëpia e Lirisë" pa vonesë, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Atëherë për të qenë racionalë dhe për ta përdorur këtë sallë në përputhje me qëllimin e saj, do t'u këshilloja të dy kolegëve që të qëndrojmë tek argumenti juridik në lidhje me çështjen dhe të respektojmë dhe kohën. Zoti Logu, po ju jap fjalën dhe nëse biem dakord, po dakordësojmë që të kemi një 3-minutësh për ju dhe një 3-minutësh të fundit për zotin Kaziaj. Jemi dakord?


**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti Celibashi!

**Z. I. Celibashi:** Zoti Logu, jemi dakord?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Po, patjetër jemi dakord!

**Z. I. Celibashi:** Në rregull! Faleminderit!


*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.02.2022*

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Unë i bashkohem në fakt thirrjes tuaj që në këtë sallë të sillemi siç jemi, si juristë, si profesionistë të ligjit, si përfaqësues ligjorë të subjekteve tona. Nuk i bën nder as zotit Kaziaj dhe as atyre që përfaqëson zoti Kaziaj, që të merren me numërim karrigesh, me blinda dyersh, me kush ka mbetur, kush ka hyrë, kush ka dalë. Kjo nga ana ime, të paktën të jetë i sigurt kushdo këtu, që ky lloj diskutimi nuk do tëekzistojë. Përsa më takon dhe për aq sa mundem dhe për aq sa unë di dhe njoh do t'i referohem vetëm ligjit, Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore që ka nxjerrë KQZ-ja. Ritheksoj dhe njëherë i nderuar që në momentin që është paraqitur kërkesa për regjistrimin e këtij koalicioni, ata që pretendojnë të jenë pjesë përbërëse e këtij koalicioni nuk kishin fituar akoma statusin, cilësinë e subjektit zgjedhor. Sepse jo më kot, pika 9 e vendimit të Komisionit Rregullator parashikon që pasi regjistrohen. Unë kam një pyetje hipotetike, çfarë do kishte ndodhur në qoftë se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendoste të mos i regjistronte si subjekte zgjedhore, Lëvizjen Socialiste për Integrim dhe Partinë Demokristiane? Do të kishim një kërkesë absurde. Një kërkesë pa shkak, pa objekt, pra një kërkesë që s'kishte sens. Kjo është arsyeja pse vendosen afatet, kjo është arsyeja pse ne duhet t'i qëndrojmë strikt respektimit të afateve. Kështu që për ne i nderuar dhe unë besoj jo vetëm për ne, por për këdo jurist që e dëgjon me vëmendje dhe i zhveshur nga emocioni politik këtë diskutim, e kupton që në momentin kur është paraqitur kërkesa, partitë që kanë paraqitur këtë kërkesë nuk e kanë pasur të drejtë. Ato nuk kishin fituar akoma cilësinë apo statusin, apo nuk ishin njohur akoma si subjekte zgjedhore, kjo është e para. E dyta i nderuar, që është me interes të drejtpërdrejtë për Partinë Demokratike të Shqipërisë. Në fakt jo vetëm në përputhje me nenin 65, por edhe 66, kërkon të shmangë çdo lloj konfuzioni që mund të bëhet ndërmjet dy subjekteve zgjedhore, në marrëveshje, në kërkesë ka një referencë të qartë ndaj Partisë Demokratike të Shqipërisë. Unë po ju

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të*

*Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve*

*Dt.04.02.2022*

informoj, siç besoj është bërë e ditur edhe për opinionin publik dhe nëpërmjet shkresave që kemi sjellë, që Partia Demokratike e Shqipërisë as nëpërmjet kryetarit të saj, as nëpërmjet përfaqësuesve zyrtarë të saj nuk ka shprehur, nuk do të shprehë dëshirën apo vullnetin siç e kërkon ligji, për të qenë pjesë e një koalicioni, ndaj çdo lloj reference që bëhet në këtë kërkesë. Sikur për një moment ta marrim të mirëqenë legjitimitimin, do të duhej që minimalisht kjo kërkesë t'i kthehej kërkuarit dhe t'i thoshte “Zotëri, brenda 24 orëve..”, siç është afati, dhe brenda ditës së sotme “..lutemi sillni një kërkesë dhe një marrëveshje që respekton faktin që Partia Demokratike e Shqipërisë është subjekt zgjedhor më vete, që nuk kërkon të jetë pjesë e asnjë koalicioni zgjedhor, aq më pak të jetë pjesë e këtij koalicioni zgjedhor”. Kjo është ajo që parashikon ligji. Kjo është ajo që ne kërkojmë t'i nënshtrohet ligjit. Ripërsëris edhe njëherë kërkesën edhe për kolegun Kaziaj edhe për këdo tjetër, që t'i lënë deklaratat politike. Retorikë politike besoj që e zotërojnë shumë herë më mirë njerëz që përfaqësojnë subjektet përkatëse dhe t'i kthehemi ligjit, Kodit Zgjedhor, akteve nënligjore për të garantuar një proces sa më të rregullt dhe për të garantuar maksimalisht zgjedhje të lira, të ndershme për të gjithë qytetarët e këtyre 6 bashkive, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Po, faleminderit zoti Logu!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Faleminderit zotik kryetar! Normalisht nuk ka sesi të dakordësoj me atë që tha zoti Logu, se dhe kjo që bëri për të thënë që është çështje teknike, përsëri e bëri nëpërmjet një deklarate politike. Kështu që nuk merret parasysh zoti koleg ajo që ju thoni, se ne këtu jemi përfaqësues ligjorë të disa subjekteve politike. Unë të një koalicioni ju të një subjekti të caktuar. Ndërkohë që ju po bëni gjithë debatin e fokusuar në këtë seancë publike të

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.02.2022*

Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve duke u kapur te sigla, ose te shkronjat nistore të një subjekti që ne kemi futur në marrëdhënie koalicioni. Nuk është kjo seanca dëgjimore dhe publike për këtë. Duhet të prisni regjistrimin e siglave. Në atë moment mund të flisni dhe përsa i përket pjesës së kundërshtimeve që mund të keni ju, të interesave të ligjshëm apo të paligjshëm që mund të keni ju. Përsa i përket pjesës së Kodit Zgjedhor, ligjvënësi ka qenë shumë i qartë. Nuk ju ka vënë në dispozicion ju si subjekt politik një Kod Zgjedhor dhe ne një tjetër. Kemi po të njëjtin Kod Zgjedhor, të ndryshuar me ligjin 101 dhe 118/2020, nga i cili janë futur dhe figurat e reja të koalicioneve nëpërmjet marrëveshjes, nëpërmjet krijimit të një partie, e cila do të udhëheqë koalicionin. Të drejtat dhe detyrimet jua lexova në pikën 3, fjalia e dytë, neni 65 “merren nga një parti”, që në rastin konkret është Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Mirë, faleminderit! Besoj që secili prej jush dha mjaftueshëm argumente në lidhje me çështjen që po shqyrtojmë. Përfundojmë këtu diskutimin nga ana juaj në lidhje me këtë çështje dhe vlerësimi i Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet në lidhje me këtë kërkesë është si vijon:

Ne konsiderojmë që duke arësytuar dhe pretendimet e përfaqësuesit të Partisë Demokratike, së pari për legjitimitetin e kërkesës, i parë ky legjitimitet në raport me afatin. Ne këtë kërkesë po e shqyrtojmë sot, në momentin që jemi duke e shqyrtuar këtë kërkesë Lëvizja Socialiste për Integrim, si parti politike figuron të jetë e regjistruar si subjekt zgjedhor. Natyrshëm nuk mund të them që pretendimi i përfaqësuesit të Partisë Demokratike ishte alogjik, por mendoj që si pretendim nuk ka bazë ligjore. Jemi duke shqyrtuar në këtë moment një kërkesë të rikonfirmuar dhe nga përfaqësuesi tashmë i subjektit zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim sot në këtë seancë publike dhe të interesit të tyre për të pasur një koalicion


*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.02.2022*

zgjedhor në këto zgjedhje. Ndaj vlerësoj që kërkesa e subjektit zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim e shqyrtuar sot për të regjistruar një koalicion me subjekt zgjedhor, të cilin ajo ka zgjedhur. Në vlerësimin tim ka legjitimitet të plotë dhe mund dhe duhet të shqyrtohet si kërkesë. Lidhur me përmbajtjen dhe me pjesën materiale apo thelbësore të pretendimit të përfaqësuesit të Partisë Demokratike, unë mendoj dhe vlerësoj që ai pretendim qëndron. Konkretisht përsa u përket disa aspekteve identifikuese, qoftë politike, por edhe zgjedhore të këtij koalicioni. Vlerësoj se nuk qëndron kërkesa e arsyetuar nga ana e përfaqësuesit të Partisë Demokratike për ta kthyer për plotësim. Pasi do të ishim në këtë situatë nëse do të kishim mungesë të dokumentacionit përkatës për të legjitimuar nga pikëpamja e Kodit Zgjedhor, kërkesën për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor në këto zgjedhje, apo në përgjithësi për zgjedhje të tjera. Ne i kemi të gjitha elementet dokumentare, të cilët duhet të mbështesin një kërkesë për t'u regjistruar një parti politike së bashku minimalisht dhe me një tjetër, si subjekt zgjedhor. Kemi dhe diçka më shumë, të cilën ne vlerësojmë që është e panevojshme minimalisht, por është dhe jo në përputhje me parashikimet e ligjit. Jemi në situatën kur kërkesa në përbërje të saj, për disa aspekte të saj, reflekton konfliktualitet sipas përcaktimeve të nenit 65 dhe 66 të Kodit Zgjedhor me interesat e ligjshme të një partie tjetër politike, apo të një subjekti tjetër zgjedhor. Ndaj kërkesa për të përfshirë në simbole, në sigla, apo edhe në thelbin e vet, elementë që lidhen me Partinë Demokratike nuk mund të pranohen. Kjo, jo vetëm për faktin që zoti Logu tha i mungon interesi Partisë Demokratike për këtë koalicion, që mendoj ishte një përcjellje e interesit të tyre në pikëpamje formale, por qartësisht kjo dihet. Por, nga ana tjetër ajo çfarë vlen më shumë është pikërisht diskutimi në lidhje me ato simbole, apo elemente të tjerë të cilat mund të krijojnë konfuzion tek zgjedhësit dhe për këtë arsye, sepse çështja e mungesës së vullnetit ishte e qartë dhe asnjëra prej palëve në këtë diskutim nuk tha

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.04.02.2022*

që, shiko ne duam të bëjmë koalicion me Partinë Demokratike, apo tjetri tha diçka tjetër. Ndaj, në vlerësim përfundimtar të gjithë sa thamë më sipër, unë vendos:

Të regjistroj si subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet e pjeshme vendore për kryetar të bashkisë që do të zhvillohen në datën 6 Mars 2022, koalicionin e partive politike Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia Demokristiane e Shqipërisë. Emri i koalicionit është “Shtëpia e Lirisë”, me shkronjat nistore Sh-L. Partia udhëheqëse e koalicionit është partia Lëvizja Socialiste për Integrim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe

Kundër këtij vendimi mundet të bëhet ankim brenda 24 orëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Faleminderit! Po zoti Logu! Këtë çështje e kemi mbyllur kështu që do të lutesha që mos ta diskutojmë.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti Celibashi! Në fakt edhe për efekt të zbatimit dhe të kuptimit të drejtë të nenit 66 të Kodit Zgjedhor, sa i përket qartësisë që duhet të kenë zgjedhësit, do të dëshiroja me mirëkuptimin tuaj që të konfirmojmë që në zgjedhjet e 6 marsit Partia Demokratike e Shqipërisë konkurren si subjekt zgjedhor më vete dhe Koalicioni “Shtëpia e Lirisë”, e përbërë nga partitë politike, Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia Demokristiane është një subjekt zgjedhor më vete dhe ndërmjet këtyre dy subjekteve nuk ka asnjë, po themi, marrëveshje apo çfarëdo lloj qoftë gjëje tjetër.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Mirë deklaratat politike thamë që duhet t'i lëmë të lutem!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të*

*Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve*

*Dt.04.02.2022*

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Ndjesë!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Janë deklarata politike, ndërkohë që miratohet një koalicion dhe ndërkohë që ...

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Unë po i referohem nenit 66, në qoftë se kolegu me ndërhyrjen e tij ka ndonjë referencë ligjore, ta thotë...

**Z. I. Celibashi:** Ju lutem! Zoti Kaziaj dhe zoti Logu, të dyve ju lutem!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Nuk i ndërhyra asnjërit..., kur flas të kemi këtë lloj etike, po themi në komunikim se jemi në një institucion. Unë dua i nderuar që t'i shërbehet sepse ka konfuzion, ka një përpjekje, po themi, dhe besoj nuk jam duke folur për një realitet që nuk e njohim, të gjithë ne sa jemi të pranishëm në këtë sallë. Ka një konfuzion, ka një përpjekje për të ngatërruar zgjedhësit.

**Z. I. Celibashi:** Zoti Logu, më fal që po ju ndërpres! Të kërkoj ndjesë për këtë, por jo më kot ju bëra me dije paraprakisht që diskutimin për këtë çështje e kemi mbyllur. Gjithsecili prej jush, qoftë juve në cilësinë e përfaqësuesit të Partisë Demokratike, apo qoftë dhe zoti Kaziaj në cilësinë e përfaqësuesit të Lëvizjes Socialiste për Integrim, apo të koalicionit të saporegjistruar mund t'i prezantojnë publikisht të gjitha shqetësimet e tyre. Me këtë rast kemi dhe prezencën e medias këtu, kështu që mund ta shfrytëzoni menjëherë këtë mundësi, por ju lutem ta respektojmë edhe njëri-tjetrin deri në formalizmin më ekstrem. Faleminderit për mirëkuptimin! Meqenëse nuk kemi çështje të tjera në rendin e ditës, seanca mbyllet. Ditën e mirë!

**Vendimi nr. 46**

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*

